



**VARBERGS
KOMMUN**

Kryetarja e keshillit komunal Ann-Charlotte Stenkil dhe drejtori i komunes Carl Bartler se bashku e kan shkruajtur nje leter te hapur per te gjithë banoret e komunes te Varbergut e cila u publikua ne varberg.se dhe ne kanalet tjera 2020-03-26.

Leter e hapur per banoret e komunes te Varbergut

Se bashku mund ta zvogelojme shperndarjen dhe te rrisim sigurine

Tani per momentin bota nuk duket me si eshte dukur me pare. Efektet e virusit te ri Korona covid-19 prek te gjitha shtetet. Pasi qe mungon vaksina dhe askush ende nuk ka arritur ta zhvilloj imunitetin shperndarja behet shume shpejt.

Ne e dijme se shumica derrmuese qe infektohet merr simptome te lehta si kollitje dhe temperatur. Ne gjithashtu e dijme se mosha e larte dhe një numër i sëmundjeve themelore janë një faktor rreziku për pasoja më serioze. Përditësime të reja mbi përhapjen dhe sëmundjen na ndodhin gjatë gjithë kohës, dhe ne gjithashtu ndiejmë shqetësim dhe pasiguri në shoqerine tone, gjithashtu edhe ne e ndejme ne komunen tone.

Për të frenuar efektet, vendimet kryesore merren si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë lokal që kanë pasoja të mëdha. Koncerte më të mëdha dhe ngjarje sportive janë të ndaluara Kompanitë përballen me kufizimet e nevojshme. Udhëtimi dhe takimet janë anuluar

Aktivitetet janë pauzuar në shume vende dhe shtetet mbyllin kufijtë e tyre Në komunen Varbergut, i kemi anuluar disa ngjarje të mëdha dhe për të mbrojtur banorët tanë më të prekur lokal, ne aktualisht nuk lejojmë vizita tek te moshuarit

Roli yt eshte me rendesi

Gjëja më e rëndësishme eshte që ju si banor lokal mund të bëni tani është të kontriboni në uljen e përhapjes se infeksionit. Ju e kete e beni duke qenë të kujdesshem në lidhje me higjienën e duarve tuaja, duke respektuar ndalimin e vizitës te te moshuarve dhe duke qëndruar në shtëpi nga puna nëse jeni i sëmurë

Nëse fëmijët tuaj janë të sëmurë, ata duhet të qëndrojnë në shtëpi nga shkolla ose qerdhja, madje edhe nese kane simptoma të buta.



Per ty qe je i shendoshe dhe nuk ke ndonje symptom

Të gjithë ne ndjehemi të shqetësuar për shkallë të ndryshme, por ju ndoshta e keni dikë që është edhe më i shqetësuar dhe që ka telashe shtesë? Atëherë një përpjekje e thjeshtë mund të bëjë një ndryshim të madh.

- Nëse keni ndonje person të moshuar në afersine tuaj, i cili ndoshta nuk mund te ketë të njëjtin informacion të shpejtë që ju e keni – merrni disa minuta për të ju shpjeguar se çfarë po ndodh në botë dhe në komunën tonë. Ndoshta mund të ju bleni një qese shtesë me artikuj ushqimor kur shkoni në dyqan sidoqoftë?
- Nëse keni një fqinj ose një të njohur që nuk flet suedisht - ndihmoni nëse është e mundur të ju përktheni atë që u thonë autoritetet tona dhe ne në komunë.
- Nëse shihni informacione në burimet sociale për të cilat dyshoni se nuk janë të sakta - zbuloni se cilat janë faktet dhe ndihmoni duke ju referuar informacionit të saktë nga autoritetet.
- Në një kohë kur vizitat dhe takimet fizike janë të kufizuara – vazhdoni te mbani kontakt dhe zgjasni një ndihmë përmes telefonit dhe kanaleve të tjera.
- Ne e dimë që iniciativat si këto qe tashmë janë ndërmarrë në komunën tonë. Ajo për të cilën po bëjmë thirrje është konsiderimi i vazhdueshëm dhe mbështetja edhe më e madhe në mesin e banorëve tanë, për të rritur sigurinë po ashtu edhe për të zvogëluar përhapjen e infeksionit.

Roli ynë është i qartë

Si drejtues i keshillit komunal ne Varberg, ne premtojmë të marrim përgjegjësinë tonë dhe të veprojmë për menaxhimin më të mirë të mundshëm të situatës. Për ndihmën tonë kemi stafin tonë, i cili aktualisht po punon jashtëzakonisht shume, veçanërisht në shkollë dhe ne qerdhe, por edhe në biznese të tjera. Punonjësit tanë janë mësuar të mbajnë kokën të ftohtë dhe zemrën të ngrohtë, këmbët të vrapojnë dhe duart të pastra, dhe tani ata po bëjnë përpjekje të jashtëzakonshme.

Ne ende kemi një kohe sfiduese përpara nesh. Atehere eshte mire qe kemi plane dhe rutina qe na ndihmojne te veprojmë ne një perspektive te koordinuar dhe afatgjate, dhe një gatishmeri per te marre vendime te shpejta nese eshte e nevojshme. Ne



**VARBERGS
KOMMUN**

**Öppet brev till Varbergs
kommuninvånare – albanska**

3 (3)

gjithashtu bejme cmos qe te arrijme tek ju si nje banor lokal me informacion te sakte dhe te rendesishem sa me shpejt qe te jete e mundur

Kujdesi për njëri-tjetrin është ndoshta mjeti më i rëndësishëm. Nëse i jepni pak më shumë kujdes , së bashku i kemi të gjitha kushtet për të kaluar ate që po na pret.

Ann-Charlotte Stenkil

Kryetare e keshillit komunal, komuna e Varbergut

Carl Bartler

Drejtori i komunes te Varbergut